

VENDIM
Nr. 270, datë 12.5.2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 96, DATË 4.2.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË DEKLARIMIT, RUAJTJES, REGJISTRIMIT DHE PAAFTËSIMIT PËR ARMËT E KOLEKSIONIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 45, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 96, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “b”, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Të jenë armë të cilat kanë kryer procedurat e regjistrimit si objekte të deklaruara pasuri kulturore pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK).”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Personi fizik dhe juridik, për regjistrimin e armëve të koleksionit ose muzeut, që nuk janë paaftësuar/çaktivizuar, pajiset me autorizim për koleksionim armësh nga komisioni qendror i ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi ka plotësuar të gjitha kriteret e neneve 34 e 35, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, si dhe kushtet e sigurisë së objektit, kriteret e sigurisë së armëve në vendin e koleksionimit ose muzeut, sipas përcaktimit të akteve nënligjore.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1 Për armët e koleksionit të deklaruara “pasuri kulturore”, të cilat janë të vjedhura ose të humbura, bëhet regjistrimi edhe në bazën e të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, sipas procedurave dhe mënyrave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.”.

4. Në pikën 4, pas fjalës “... paraqet ...” shtohet fjala “... *online*, në portalin unik qeveritar, *e-Albania*.”.

5. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Personi fizik dhe juridik, për të marrë autorizimin si koleksionist ose person i autorizuar për administrimin e armëve në muze, paraqet kërkesën përmes platformës *online*, dokumentacionin dhe listën me armët që zotëron, pranë IKRTK-së, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.”.

6. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Armët e koleksionit dhe armët e koleksionit të deklaruara pasuri kulturore u nënshtrohen parashikimeve të legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore, në përputhje me rregullat e ndryshimit të pronësisë së armëve, sa u përket mbajtjes, mbrojtjes, vlerësimit, administrimit dhe tjetërsimit të pronësisë së tyre.”.

7. Pas pikës 10 shtohet pika 10/1, me këtë përmbajtje:

“10/1 Për armët e koleksionit të deklaruara pasuri kulturore, importi ose eksporti i tyre kryhet përmes lëshimit të licencave të import/eksportit të pasurive kulturore.

Shitblerja e armëve të koleksionit të deklaruara pasuri kulturore i nënshtrohet procedurave të parashikuara në vendimin nr. 199, datë 31.3.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shqyrtimin ose anulimin e licencës, tarifat e kërkesës dhe kuotizacionin vjetor të licencave për veprimtari tregtare të pasurive kulturore”.”.

8. Në pikën 11, pas fjalisë së parë shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Për armët e koleksionit të deklaruara pasuri kulturore lëvizja dhe transportimi bëhet në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.”.

9. Në pikën 12, pas fjalisë së parë shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Për armët e koleksionit të deklaruar pasuri kulturore kërkohet autorizimi i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.”.

10. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“14. Çaktivizimi/paaftësimi i armëve të koleksionit kryhet me të njëjtën procedurë dhe të njëjtat kriterë si edhe për armët e tjera. Çaktivizimi/paaftësimi bëhet nga persona fizikë ose juridikë, të pajisur me licencë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për çaktivizimin/paaftësimin e armëve të zjarrit për përdorim civil.”.

II. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe